



Nga: Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë (YIHR KS)

Për: Kryetaren e Gjykatës Themelore në Prishtinë, znj. Afërdita Bytyçi

Data: 16 tetor 2020

Reagim për shkelje të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë

E nderuara znj. Bytyçi,

Po ju shkruajmë rreth një raportimi që kemi pranuar në kuadër të platformës “E Drejta Jem”¹ për shkelje të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë. Kjo platformë online është krijuar në kuadër të projektit “Të rinjtë për drejtësi” dhe përmban informacione për të drejtat e njeriut dhe sistemin e drejtësisë në Kosovë, si dhe për të raportuar rastet e shkeljes së dispozitave ligjore.

Në raportimin e pranuar është adresuar çështja e takimit të një gjyqtari me prokurorin jashtë seancës në Gjykatën Themelore në Prishtinë pa qenë prezent avokati, duke vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarit në procesin gjyqësor e që është në kundërshtim me këto dispozita ligjore:

- Nenin 2 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë “Gjyqtari gjatë ushtrimit të funksionit të tij i trajton të gjitha palët në procedurë në mënyrë të barabartë, pa favorizime, anonime dhe paragjykitime. Gjatë gjithë kohës gjyqtari duhet të jetë dhe duhet të duket i paanshëm. Paanshmëria ka të bëjë jo vetëm me vendimin, por edhe me procedurën e marrjes së vendimit.”; paragrafin 2.1 “Gjyqtari me sjelljet e tij në gjykatë dhe jashtë gjykatës ruan dhe avanon besimin e publikut dhe palëve në paanshmërinë e tij dhe gjyqësorit në përgjithësi”; dhe paragrafin 2.3. “Gjyqtari në relacionet e tij personale dhe me pjesëtarët e komunitetit të drejtësisë i shmanget situatave në të cilat në mënyrë të arsyeshme mund të vë në dyshim paanshmërinë e tij”.
- Nenin 5 të Ligjit për Përgjegjësinë Diciplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, paragrafin 2 “Shkelje e detyrave të gjyqtarit, sipas këtij ligji, përfshin veprimet e mëposhtme, në qoftë se gjyqtari i kryen me dashje ose nga pakujdesia e rëndë”, paragrafin 2.2. “nuk i trajton siç kërkohet me ligj palët në procedurë, përfaqësuesit e tyre, dëshmitarët, dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë” dhe paragrafin 2.8 “përfshihet në çfarëdo komunikimi ex-parte, lidhur me lëndët”.

¹ <http://edrejtajem.org/>



- Nenin 39 paragrafin 3 të Kodit të Procedurës Penale: “Gjyqtari gjithashtu mund të përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në rast konkret, nëse përpos rasteve nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni, prezantohen dhe vërtetohen rrethana që e vënë në dyshim paanshmërinë e tij ose që duken të papërshtatshme.”

Vlen të theksohet se shkelje të tilla kanë ndodhur disa herë më parë në sistemin e drejtësisë në Kosovë, jo vetëm në mes të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Por, ka edhe raste tanimë publike ku prokurorët dhe gjyqtarët janë takuar bashkarisht me të akuzuarin jashtë ndërtesës së gjykatës dhe kanë zhvilluar komunikime ‘ex partes’, ku pa prezencën e të dëmtuarit kanë diskutuar rreth lëndës në të cilën kanë qenë në procedurë.²

Ne e konsideruam të nevojshëm komunikimin me gjykatën tuaj rreth kësaj çështjeje, pasi veprime të tilla çënojnë paanshmërinë e sistemit gjyqësor dhe rrezikojnë besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë në vend. Ne kërkojmë që të shtohen masat vëzhguese dhe disiplinuese ndaj rasteve të tilla në mënyrë që të ngritet besimi qytetar në sistemin gjyqësor.

Të njëjtin reagim programi ynë do ta publikojë në platformën “E Drejta Jem” si dhe në platformat tjera online.

Presim nga ju që të na informoni mbi veprimet që do të ndërmerren kundrejt këtij reagimi.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin e deritanishëm.

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë (YIHR KS)

²Disa raste të bëra publike ku gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët bien ndesh me Kodin e Etikës, mund të gjenden në linqet e mëposhtme:

<https://kallxo.com/lajm/ne-emer-te-popullit-me-duar-ne-xhepa/> ;

<https://kallxo.com/shkurt/prokurori-e-gjyqtari-nen-hetime-pas-drekes-me-te-akuzuarin/>

<https://kallxo.com/gjate/hulumtim/dreka-e-gabuar-e-prokurorit-te-akuzuarin/> ;

<https://kallxo.com/shkurt/pazaret-ne-prokurorine-e-prizrenit/>

<https://kallxo.com/uncategorized/skandal-prokurori-filmohet-duke-negociuar-denim-me-te-ulet-per-biznesmenin/>